



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1768 Prot.

Tiranë, më 22.04.2026

VENDIM

Nr. 3, Datë 22.04.2026

**PËR SHPALLJEN E DY VENDEVE VAKANTE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT  
TË LARTË GJYQËSOR NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË  
DREJTËSISË DHE SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Në mbështetje të neneve 36 dhe 37 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 dhe 16 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

**V E N D O S A:**

1. Shpalljen e dy vendeve vakante për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.
2. Shërbimet e Kuvendit të bëjnë shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale zyrtare të Kuvendit. Në shpallje të përfshihen kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët sipas neneve 36 dhe 39 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

